



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E "MURIT TË NDERIT", KUSHTUAR SAKRIFICËS VETËMOHUESE TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS PËR TË SHPËTUAR HEBRENJTË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

- I. **MIRATOHET** Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit" (Wall of Honor), kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- II. Lokacioni për vendosjen e "Murit të Nderit" (Wall of Honor), shtrihet në parcelën kadastrale nr. 6559-0, ZK Prishtinë, në pronësi PSH, KK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për vendosjen e këtij muri.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit dhe projekti ideor.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/02-275287/19, më 08.11.2019



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e “ Murit të Nderit”, kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën e kryetarit të Komunës drejtuar kësaj drejtorie përmes e-mailit zyrtar, për caktimin e lokacionit për vendosjen e “Murit të Nderit” (Wall of Honor), kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kërkesa ka ardhur në emër të Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, organizatës së vetme lobuese të regjistruar në Uashington, DC, të udhëhequr nga kongresisti Joe DioGuardi dhe znj. Shirley Cloyes DioGuardi, këshilltare për çështje të Ballkanit.

Bazuar në kërkesë, viti 2019 shënon 30-vjetorin e punës aktive dhe të palodhur të lobit tonë në SHBA për kauzën kombëtare shqiptare. Liga ka qenë dhe vazhdon të jetë ndërtuesja kryesore e marrëdhënieve të singerta miqësore në mes SHBA-së dhe Kosovës, në veçanti, por edhe faktorit shqiptar në Ballkan në përgjithësi.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e “Murit të Nderit” (Wall of Honor), kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për rekreacion, parku i qytetit. Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 6559-0, ZK Prishtinë, në pronësi – PSH, KK Prishtinë.

Lokacioni për vendosjen e këtij muri është propozuar në mes të këtij parku, përkatësisht në oazën e gjelbërimit që e përshkon shëtitorja në të dy anët, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë caktimi i lokacionit sipas kërkesës. DPSZHQ-ja ka njoftuar Drejtorinë e Parqeve, që ky memorial-mur të inkorporohet në projektin e parkut, i cili është në hartim e sipër.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se kjo hapësirë e caktuar ku do të vendoset memoriali “Muri i Nderit”, është sipërfaqe e gjelbëruar, e cila duhet të ruhet, duke ruajtur gjelbërimin ekzistues gjatë vendosje në bazë të projektit ideor të bashkëngjitur.

Bashkëngjitur:

Ortofoto e lokacionit dhe projekti ideor.

Lokacioni i propozuar për vendosjen e “ Muri i Nderit”.

